ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	616-24-3392-5-1-1
Nr i brendshëm	616 24 043 511

Sa i përket tenderit për: **"122 Ndertimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit te ndriqimit publik" Lot 2, 3 dhe 4.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Risamont SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Brahim Ademi, Bregu i Diellit

(Adresa)

Prishtinë ***10 000***

(Vendi) *(Kodi postar)*

+38349393528

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Riad Rexhepi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

risamont@gmail.com
(Adresa elektronike)

13.09.2024
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

SH.P.K. RISAMONT PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 05.04.2024 Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 10.04.2024 Vendimi i AK: 30.08.2024 Kërkesa për rishqyrtim dt. 04.09.2024 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt:05.09.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 6 i LPP-së** **Neni 7 i LPP-së** **Neni 51 i LPP-së** **Neni 53 i LPP-së** **Neni 61 i LPP-së** **Neni 65 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së** **Neni 70 i LPP-së** **Neni 72 i LPP-së**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me date: 02.09.2024 kemi pas qasje ne dokumente te tenderit te OE te propozuar për kontrate. Pas analizës se dokumenteve të tenderit përkatësisht dokumenteve të OE të rekomanduar për kontratë, kemi vërejtur se i njëjti është i papërgjegjshëm dhe një gjë të tillë do ta dëshmojmë me faktet dhe argumentet e mëposhtme:

LOT 2- OE i propozuar për kontrate **INFINIT LIGHTING SHPK** është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Në dosje të tenderit përkatësisht tek kapaciteti teknik dhe profesional është specifikuar kërkesa si në vijim:

2. Katalogu origjinal ose kopje dhe të jetë në përputhje me specifikat teknike për trupa ndriques- Pozicioni 1, 2, 3. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Katalogun për pozicionet e kërkuara

Te dhënat teknike te produktit te kërkuar:

Fuqia e LED-it:50W, 100W dhe 150W
Tensioni punës: 220-240 V AC, 50/60 Hz,
Puna në temperaturë:≥-30°C deri +50°C
Ndriçuesi i LED-it: ≥150 lm/W
CRI: Ra≥70
Faktori i fuqisë ≥0.95
Ngjyra e temperaturës –Natyrale:4000K
Mbrojtja ≥ IP66
Rezistenca minimale ndaj ndikimit ≥IK08
Garancioni ≥ 5 vite
Materiali: Alumin i derdhur ,ngjyra e trupit ndriques :black, silver ose gray
Jetëgjatësia e ndriçuesit ≥100.000 h
Mbrojtja nga mbitensioni ≥6kV
Izolimi i mbrojtjes elektrike: Klasa I
Sistemi Optik nga PMMA

Te gjeturat dhe gabimet:

OE i propozuar për kontrate ka prezantuar autorizim nga dy prodhues të ndryshëm: UNICOMLITE dhe DIECASTINGMANLIGHT.
OE i propozuar për kontrate ka ofertuar me dy prodhues për pozicionet e njëjta, pra:

1.**Me prodhuesin UNICOMLITE** ka prezantuar produktin META LED Street lights me karakteristikat teknike si më poshtë:
24-200W
Housing: Die-cast Aluminum
Thermal Conductivity: 96 W/m·K
Led: PHILIPS
CRI: Ra>70
SDCM: <6
Power Factor: >0.95
THD: <15
Driver: Meanwell XLG
Driver Efficiency: >90%
Protection: OTP, OCP, OVP, SCP
Surge Protection: 6kV
Waterproof: IP66
Impact Test: IK08
Electrical: 100-277V, 50/60Hz
Operating Temperature: -40~50
TM21: L90B10>50,000H
Lifetime: 50,000H.

Produkti i lartcekur nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit, pasi që jetëgjatësia e trupit ndriçues është kërkuar të jetë**: Jetëgjatësia e ndriçuesit ≥100.000 h,** ndërsa produkti i OE të rekomanduar për kontratë ka jetëgjatësinë: **Lifetime: 50,000H.**

2.**Me prodhuesin DIECASTINGMANLIGHT** ka prezantuar produktin YASIL-09 me karakteristikat teknike si në vijim:
30-60W, 50-100W dhe 100-200W
Housing: Die-cast Aluminum
Power Factor: >0.95
Protection: OTP, OCP, OVP, SCP
Surge Protection: 10-15-20kV
Waterproof: IP66
Impact Test: IK08
Electrical: AC90-305V, 50/60Hz
Operating Temperature: -30~45
Lifetime: Nuk disponon me kete parameter

Produkti i lartcekur nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit, pasi që jetëgjatësia e trupit ndriçues është kërkuar te jete: Jetëgjatësia e ndriçuesit ≥100.000 h, ndërsa produkti është ofruar me parametrat e jetëgjatësisë si në vijim: Lifetime: Nuk e disponon këtë parametër, ndërsa ne katalogun bazë ky parametër figuron: Lifetime:50,000.00h.

Kur kemi parasysh faktet e lartcekura atëherë kuptohet qartë se asnjëri nga produktet e lartcekura të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson parametrat e kërkuara nga AK-ja te përshkruara ne përshkrim te çmimeve dhe te kërkuara ne FDT.
Gjithashtu duhet cekur fakti se në dosje të tenderit tek neni 4.1 variantet nuk janë të autorizuara, andaj OE i rekomanduar për kontratë është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit sepse ka ofertuar me variante, pra ka prezantuar dy produkte, nga dy prodhues të ndryshëm, pra në këtë rast kemi të bëjmë edhe ma variante.

Edhe po ti plotësonte ndonjëri prej këtyre prodhuesve parametrat dhe specifikat teknike të kërkuara përsëri ky OE është i papërgjegjshëm sepse ka ofertuar me variante.

Tek kërkesa nr.6 e dosjes së tenderit është kërkuar *"OE duhet që gjatë tenderimit ti dorëzojë mostrat para hapjes së ofertave për pozicionet Loto 2, 3, dhe 4-poz- 1, 2, dhe 3 sipas karakteristikave minimale*. Dëshmi dokumentare: *Mostrat e kërkuara.*

Mostra e dorëzuar nga OE është një trup ndriçues i cili ka të vendosur një stiker me ngjitës ne trupin ndriçues me te dhënat teknike: 100W; Efficancy: 150lm/w; AC100-277V•50/60Hz Color Temperature: 4000K.

Mostra e dorëzuar nuk disponon me te dhënat bazike te prodhuesit si dhe me te dhënat tjera të cilat do duhej të ishin konform te dhënave teknike te produktit te ofertuar me katalog.
Produkti ngjason me modelin e ofertuar YASL-09, mirëpo te dhënat e produkti te vendosura ne stiker me ngjitës ne mostrën e produktit, nuk janë te njëjta me te dhënat e produktit ne katalog **(ne katalog parametri i tensionit AC90-305V, ndërsa ne stiker AC100-277V etj)**. Përveç tjerash, duket se stikeri i është vendosur mostrës me te dhëna sipas kërkesës së AK, respektivisht teksti ne gjuhen angleze është i shkruar gabim, gjë qe e vërteton një gjë te tille.

Duke pasur parasysh faktet e lartcekura, kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së, pasi që i njëjti ka prezantuar dy produkte të ndryshme në katalog, ndërsa mostra e prezantuar nuk është në përputhje me asnjërën nga produktet e prezantuara në katalog.

11.Operatori Ekonomik (Shërbyesit e energjisë) duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.

Deshmia: 11. Një listë te pajisjeve, sipas Aneksin 7, Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim.

Nr.	**Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve**	**Sasia e kërkuar (copë)**			
		Lot 1	**Lot2**	**Lot3**	**Lot4**
1.	**Kamion me shportë ngritëse ≥10 metra lartësi.**	**2**	**2**	**2**	**2**
2.	**Kamion vinç me peshë mbajtëse ≥10 metra lartësi**	**1**	**1**	**1**	**1**
3.	**Eskavator 4x4, me lugë ngarkuese para dhe mbrapa.**	**1**	**1**	**1**	**1**
4.	**Kamion kiper, minimumi 3m^3.**	**1**	**1**	**1**	**1**

Vërejtje: OE duhet ta plotësoj kolonën D me te gjitha te dhënat për pajisjet e ofruara siç është (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamiona rexhistrimi i targave, mekanizimi, dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim, foto etj)

Më poshtë po i prezantojmë mangësitë e OE të rekomanduar për kontratë në lidhje me pajisjet e prezantuara nga i njëjti:

1. Automjeti korpa me targa: 03-917-IF me marrëveshje shfrytëzimi.

Për pajisjen e lartcekur nuk është prezantuar ndonjë dëshmi dokumentare se automjeti shporta operon ne lartësi ngritëse ≥10 metra lartësi, ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit.

Eskavatori ne targa 01-111-VA është ç'regjistruar – jashtë përdorimit. Andaj edhe në këtë rast nuk është plotësuar kërkesa e AK-së rreth pajisjeve te regjistruara që duhet të jenë me libreza me validitet.

3. Kamioni me vinç me targa 01-218-JJ

Për pajisjen e lartcekur nuk janë ofruar dëshmi dokumentare se automjeti vinç operon me peshë mbajtëse ≥10 metra lartësi sipas kërkesës se AK.

4. Kamioni kiper me targa 01-05-2921, regjistrimi i fundit 12.05.2021

Pra pajisja e lartcekur është në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit sepse e njëjta nuk posedon regjistrim valid.

5. Automjeti korpa me targa: 01-137-UD me marrëveshje shfrytëzimi.

Për pajisjen e lartcekur nuk është prezantuar ndonjë dëshmi dokumentare se automjeti shporta operon ne lartësi ngritëse ≥10 metra lartësi, ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit.

6. Ngarkues me lopate VOLVO BEL 71 me marrëveshje.

Kërkesa e AK ka qenë: Eskavator 4x4, me lugë ngarkuese para dhe mbrapa, ndërsa për këtë pajisje nuk janë prezantuar dëshmi konkrete ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit.

Pra nga të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, andaj i njëjti është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit dhe jo të rekomandohet për kontratë.
Nga këto dëshmi kuptohet se nuk janë plotësuar specifikimet e kërkuara, prandaj është e çuditshme se i autoriteti kontraktues rekomandon për kontratë me gjithë këto mangësi.

- **Pershkrimi i çmimit- Oferta financiare: Deshmia: Kriteret e Dhënies Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët;**

Oferta financiare (pershkrimi i cmimeve) e OE te propozuar për kontrate, nuk ndryshon nga ofertat financiare te OE tjerë pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit, respektivisht ne gjithsej 72 pozicione sa ka secili LOT, shumica e pozicioneve kanë çmime jo-normalisht te ulëta, ndërsa pozicione te caktuara kanë çmime tej normalisht të larta, mirëpo përmes formimit te çmimeve për pozicione, atëherë vije deri te arsyeshmëria teknike-financiare.
Pra OE i rekomanduar për kontratë ka bërë manipulime në çmime, ku në disa pozicione ka dhënë çmime jo normalisht të ulëta, ndërsa në disa pozicione tjera ka dhënë çmime tej normalisht të larta të cilat nuk përkojnë me çmimet e tregut. Autoriteti kontraktues është dashur ti analizoj në tërësi të gjitha çmimet e OE të rekomanduar për kontratë dhe të veproj konform dispozitave të nenit 61 të LPP-së, mirëpo që një gjë të tillë nuk e ka bërë.
Autoriteti kontraktues ka qenë i njëanshëm në trajtimin e ofertave, sepse neve na eliminon për çmime jonormalisht të ulëta edhe pse ne i kemi çmimet e tregut dhe mund ti arsyetojmë të gjitha, kurse në anën tjetër rekomandon për kontratë një OE i cili ka vendosur çmime manipulative, e për më tepër nuk kërkon as sqarime.

LOT 3- OE i propozuar për kontrate JAVNA RAZFETJAVLA d.oo, është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë *"Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, nga data e njoftimit për kontrat në vlerë minimale prej: Loto 2 800,000.00 Euro. Loto 3 500,000.00 Euro. Loto 4 500,000.00 Euro". Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve".*

OE i propozuar për kontrate ka plotësuar ANEKSIN 6 ku figurojnë tri kontrata dhe referencat respektive.

Kontrata e renditura me numrat rendor: 1 dhe 2, janë kontrata të periudhës kohore 2019-2020, andaj të njëjtat nuk mund dhe nuk duhet të merren parasysh, ndërsa vetëm kontrata me numër rendor:3 e vitit 2022 është e vlefshme dhe ka vlerën: 425,395.00€.
Si përfundim ashtu siç specifikohet edhe me LPP konkretisht paragrafin 6.2 të nenit 69 të LPP-së përcaktohet se duhet të listohen kontratat dhe referencat për tri vitet e fundit nga , e në këtë rast vitet: 2021, 2022 dhe 2023 dhe si i tillë i njëjti nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Gjithashtu në dosje të tenderit është specifikuar kërkesa si në vijim:
2. Katalogu origjinal ose kopje dhe të jetë në përputhje me specifikat teknike për trupa ndriques- Pozicioni 1, 2, 3. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Katalogun për pozicionet e kërkuara:

Për kërkesën e lartcekur OE i propozuar për kontrate ka prezantuar autorizim nga dy prodhues të ndryshëm: UNICOMLITE dhe DIECASTINGMANLIGHT.
OE i propozuar për kontrate ka ofertuar me dy prodhues për pozicionet e njëjta, pra:

1. Me prodhuesin UNICOMLITE me produktin META LED Street lights me karakteristikat teknike:
   24-200W
   Housing: Die-cast Aluminum
   Thermal Conductivity: 96 W/m·K
   Led: PHILIPS
   CRI: Ra>70
   SDCM: <6
   Power Factor: >0.95
   THD: <15
   Driver: Meanwell XLG
   Driver Efficiency: >90%
   Protection: OTP, OCP, OVP, SCP
   Surge Protection: 6kV
   Waterproof: IP66
   Impact Test: IK08
   Electrical: 100-277V, 50/60Hz
   Operating Temperature: -40~50
   TM21: L90B10>50,000H
   Lifetime: 50,000H.

Produkti i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat e DT, pasi qe jetëgjatësia e trupit ndriçues është kërkuar te jete: Jetëgjatësia e ndriçuesit ≥100.000 h, ndërsa është ofertuar: Lifetime: 50,000H.

2. Me prodhuesin DIECASTINGMANLIGHT me produktin YASIL-09 me karakteristikat teknike:
   40W-60W-180W
   Housing: Die-cast Aluminum
   Power Factor: >0.95
   Protection: OTP, OCP, OVP, SCP
   Surge Protection: 10-15-20kV
   Waterproof: IP66
   Impact Test: IK08
   Efficiency: 120lm/W
   Electrical: AC90-305V, 50/60Hz
   Operating Temperature: -40~50

Lifetime: 50 000h

Produkti i ofertuar nuk i plotëson kërkesat e DT, pasi qe janë kërkuar:
Jetëgjatësia e ndriçuesit ≥100.000 h, ndërsa është ofruar: Lifetime: 50 000h
Ndriçuesi i LED-it: ≥150 lm/W, ndërsa është ofertuar 120lm/W si dhe
Janë kërkuar fuqitë: 50W, 100W dhe 150W, ndërsa janë prezantuar fuqitë: 40W,60W dhe 180W.
Kur kemi parasysh faktet e lartcekura atëherë kuptohet qartë se asnjëri nga produktet e lartcekura të prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson parametrat e kërkuara nga AK-ja te përshkruara ne përshkrim te çmimeve dhe te kërkuara ne FDT.
Gjithashtu duhet cekur fakti se në dosje të tenderit tek neni 4.1 variantet nuk janë të autorizuara, andaj OE i rekomanduar për kontratë është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit sepse ka ofertuar me variante, pra ka prezantuar dy produkte, nga dy prodhues të ndryshëm, pra në këtë rast kemi të bëjmë edhe ma variante.

- *OE duhet që gjatë tenderimit ti dorëzojë mostrat para hapjes së ofertave për pozicionet Loto 2, 3, dhe 4-poz- 1, 2, dhe 3 sipas karakteristikave minimale. Dëshmi dokumentare: Mostrat e kërkuara.*

Mostra e dorëzuar nga OE është një trup ndriçues i cili ka të vendosur një stiker me ngjitës në trupin ndriçues me të dhënat teknike:
100W
Efficancy: 150lm/w
AC100-277V•50/60Hz
Color Temperature: 4000K

Mostra e dorëzuar nuk disponon me te dhënat bazike te prodhuesit si dhe me te dhënat tjera te cilat do duhej te ishin konform te dhënave teknike te produktit te ofertuar me katalog.
Produkti ngjason me modelin e ofertuar YASL-09, mirëpo te dhënat e produkti te vendosura ne stiker me ngjitës ne mostrën e produktit, nuk janë te ngjashme me te dhënat e produktit ne katalog **(ne katalog parametri i tensionit AC90-305V, ndersa ne stikser AC100-277V etj)**, përveç tjerash, duket se stikeri i është vendosur mostrës me te dhëna sipas kërkesës se AK, respektivisht teksti ne gjuhen angleze është i shkruar gabim, gjë qe e vërteton një gjë te tille.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet e lartcekura, kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së, mirëpo një gjë e tillë nuk është bërë, duke u favorizuar OE i rekomanduar për kontratë edhe pse është i papërgjegjshëm.

- *11.Operatori Ekonomik (Shërbyesit e energjisë) duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.*

  Deshmia: 11. Një listë te pajisjeve, sipas Aneksin 7, Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim.

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (copë)			
		Lot 1	Lot2	Lot3	Lot4
1.	Kamion me shportë ngritëse ≥10 metra lartësi.	2	2	2	2
2.	Kamion vinç me peshë mbajtëse ≥10 metra lartësi	1	1	1	1
3.	Eskavator 4x4, me lugë ngarkuese para dhe mbrapa.	1	1	1	1
4.	Kamion kiper, minimumi 3m^3.	1	1	1	1

Vërejtje: OE duhet ta plotësoj kolonën D me te gjitha te dhënat për pajisjet e ofruara siç është (viti I prodhimit , gjendja e pajisjes , kamiona rexhistrimi i I targave, mekanizimi , dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim , foto etj)

Më poshtë po i prezantojmë mangësitë e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë në lidhje me pajisjet e kërkuara:

1. Automjeti korpa me targa: LJ-JRL-140-IF me regjistrim deri me: 01.06.2023, nuk ka regjistrim valid.

Për automjetin e lartcekur nuk është prezantuar asnjë dëshmi dokumentare se automjeti shporta operon ne lartësi ngritëse ≥10 metra lartësi sipas kërkesës se AK. Gjithashtu pajisja e lartcekur nuk është konform kërkesës së lartcekur për faktin se pajisja e lartcekur nuk ka regjistrim valid ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit.

2. Kamioni me vinc me targa LJ-JRL-114

Për automjetin e lartcekur nuk është prezantuar asnjë dëshmi dokumentare se automjeti shporta operon ne lartësi ngritëse ≥10 metra lartësi sipas kërkesës se AK.

3. Kamioni kiper me targa LJ-JAL=130, me regjistrim deri me: 01.09.2024, nuk ka regjistrim valid.

Pajisja e lartcekur nuk është konform kërkesës së lartcekur për faktin se pajisja e lartcekur nuk ka regjistrim valid ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit.

4. Automjeti korpa me targa: LJ-JRL-105.

Për automjetin e lartcekur nuk është prezantuar asnjë dëshmi dokumentare se automjeti shporta operon ne lartësi ngritëse ≥10 metra lartësi sipas kërkesës se AK..

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, andaj si e tillë është dashur të konsiderohet si e papërgjegjshme, mirëpo që autoriteti kontraktues nuk e ka bërë një veprim të tillë.
Veprimet e AK-së kanë qenë veprime diskriminuese përkatësisht favorizuese duke vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, pasi që neve nuk na ka trajtuar në mënyrë të barabartë.

Oferta financiare (pershkrimi i cmimeve) e OE te propozuar për kontrate, nuk ndryshon nga ofertat financiare e OE të tjerë pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit, respektivisht ne gjithsej 72 pozicione sa ka secili LOT, shumica e pozicioneve kanë çmime jo-normalisht te ulëta. Ndërsa pozicione te caktuara kanë çmime tej normalisht te larta dhe jo në harmoni me çmimet e tregut.

Pra edhe ky OE ka ofertuar me çmime manipulative, ku për disa pozicione ka dhënë çmime jo normalisht të ulëta, e për disa pozicione tjera ka dhënë çmime të cilat janë tej normalisht të larta dhe nuk përkojnë fare me çmimet e tregut. Autoriteti kontraktues edhe në këtë rast është dashur të veproj konform dispozitave të nenit 61 të LPP-s dhe të kërkoj sqarime në lidhje me këto çmime mirëpo që një gjë të tillë nuk e ka bërë,, duke favorizuar OE e rekomanduar për kontratë.

LOT 4- OE i propozuar për kontrate MVR ELEKTROMONTUES, është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

Në dosje të tenderit përkatësisht tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar "*11.Operatori Ekonomik (Shërbyesit e energjisë) duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT. Deshmia: 11. Një listë te pajisjeve, sipas Aneksin 7, Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytezim.*

Nr.	**Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve**	**Sasia e kërkuar (copë)**			
		Lot 1	**Lot2**	**Lot3**	**Lot4**
1.	**Kamion me shportë ngritëse ≥10 metra lartësi.**	**2**	**2**	**2**	**2**
2.	**Kamion vinç me peshë mbajtëse ≥10 metra lartësi**	**1**	**1**	**1**	**1**
3.	**Eskavator 4x4, me lugë ngarkuese para dhe mbrapa.**	**1**	**1**	**1**	**1**
4.	**Kamion kiper, minimumi 3m^3.**	**1**	**1**	**1**	**1**

Vërejtje: OE duhet ta plotësoj kolonën D me te gjitha te dhënat për pajisjet e ofruara siç është (viti I prodhimit , gjendja e pajisjes , kamiona rexhistrimi i I targave, mekanizimi , dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim , foto etj)

1. Automjeti korpa me targa: 01-723-LI.

Për automjetin e lartcekur nuk është prezantuar asnjë dëshmi dokumentare se automjeti shporta operon ne lartësi ngritëse ≥10 metra lartësi sipas kërkesës se AK.

2. Kamioni kiper me kran me targa 01-507-ZD me regjistrim 27.07.2024

Është kërkuar: Kamion vinç me peshë mbajtëse ≥10 metra lartësi, ndërsa është prezantuar kamion kiper me kran.
Gjithashtu nuk është prezantuar asnjë dëshmi dokumentare se automjeti vinç operon peshë mbajtëse ≥10 metra lartësi sipas kërkesës se AK.
Gjithashtu nuk është plotësuar kërkesa e dosjes së tenderit në lidhje me validitetin e regjistrimit të pajisjes.

3. Eskavator JCB 4CX.

Përveç marrëveshjes dhe dudit doganor, nuk është prezantuar ndonjë foto e pajisjes ashtu siç është kërkuar nga AK..

4. Automjeti korpa me targa: 01-755-LT.

Për automjetin e lartcekur nuk është prezantuar asnjë dëshmi dokumentare se automjeti shporta operon ne lartësi ngritëse ≥10 metra lartësi sipas kërkesës se AK.

Nga faktet e lartcekura kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së, mirëpo që një veprim i tillë nuk është bërë, duke mos u respektuar kështu dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

Oferta financiare(pershkrimi i cmimeve) e OE te propozuar për kontrate, nuk ndryshon nga ofertat financiare te OE tjerë pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit, respektivisht ne gjithsej 72 pozicione sa ka secili LOT. Shumica e pozicioneve kanë çmime jo-normalisht te ulëta, ndërsa pozicione te caktuara kanë çmime jo normalisht te larta, mirëpo përmes formimit te çmimeve për pozicione, atëherë vije deri te arsyeshmëria teknike-financiare.

Pra nga këto fakte kuptohet se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime manipulative dhe autoriteti kontraktues është dashur të veproj konform dispozitave të nenit 61 të LPP-së, mirëpo që një gjë të tillë nuk e ka bërë duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e lartcekur.

Në lidhje me arsyet tona të eliminimit, autoriteti kontraktues ka dhënë arsyet si në vijim:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

1. Çmimi i ofertuar është jo normalisht i ulët sepse është dukshëm me i ulet sesa 30% nen mesataren e çmimit mesatar me te cilin kane ofertuar tenderuesit OE ne këtë AP si dukshëm me shume sesa 10% nen çmimin e dyte me te lie pas tij.

Në lidhje me arsyen e lartcekur të eliminimit ju sqarojmë se në nenin *61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët thuhet:*

1. *Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.*

2.1. *Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me: ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;*

2.2.çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
2.3.çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
2.4.origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura kuptohet qartë se autoriteti kontraktues është dashur të kërkoj sqarime në lidhje me çmimet me të cilat ne kemi ofertuar, nëse më të vërtetë ka konsideruar se ne kemi ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta. Vlen të ceket fakti se autoriteti kontraktues me dt.05.06.2024 na kishte kërkuar sqarime shtesë si në vijim: (*Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve te dhena ne Dosjen e tenderit dhe ne Njoftimin per Kontrate. Ne konsiderojme qe tenderi juaj eshte jo-normalisht i ulet per te gjitha lotet ne krahasim me objektin e kontratës, andaj kerkojme qe te sqaroni cmimin tuaj dhe formimin e tij per pozicionet nga 1.2.3.4.5 dhe 6 per te gjitha lote qe ju keni ofertuar*). Pra me njoftimin mbi vendimin e AK-së te datës: 14.06.2024 ne jemi shpallur fitues nga ana e AK për LOT4 pasi që kemi dërguar sqarimet adekuate rreth ekonomisë se procesit.
Ky veprim i AK-së është dashur të bëhet edhe tani para publikimit të njoftimit mbi vendimit të saj, nëse ka konsideruar se kemi çmime jo normalisht të ulëta, pasi qe te gjitha ofertat tjera janë me çmime njësi pothuajse identike, diku me çmime jo-normalisht te ulëta dhe diku me çmime jo-normalisht te larta, mirëpo me formimin e çmimit dhe shpjegimet rreth ekonomisë se procesit, atëherë arsyetohen çmimet e ofertuara.

Në këtë rast autoriteti kontraktues na ka diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit, për shkak se na ka eliminuar pa na kërkuar sqarime shtesë fare, ndërsa ka rekomanduar për kontratë OE të cilët kanë ofertuar me çmime pothuajse identike sikurse tonat dhe atë pa ju kërkuar sqarime fare.

Arsyeja tjetër për eliminimin tonë ka qenë se *"Nuk eshte permbushur kerkesa 7.3 lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional ne DT. Mungone pese punonjes teknik me SSHP, CV, Kontrate dhe diploma. Vetem per 3 punonjes jane dorezuar dokumentet e kompletuara".*

Në lidhje me këtë arsye të eliminimit, ju sqarojmë se kërkesë e dosje së tenderit ka qenë "*7.3. Minimum 10 Punëtorë, të cilët duhet të jenë të çertifikuar për siguri në punë për LLOTO 1 Kurse për LLOTOT 2, 3, dhe 4 kërkohet minimum 5 punëtor të cilët duhet të jenë të çertifikuar për siguri në punë. Deshmia CV, diploma apo certifikata, Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete Project",*

Fillimisht ju sqarojmë se autoriteti kontraktues nuk e ka bërë interpretimin e kërkesës së dosjes së tenderit në mënyrë të duhur, për faktin se kërkesa dosjes së tenderit nuk është për pesë punonjës teknik ashtu siç pretendon AK, mirëpo është specifikuar: *Kurse për LLOTOT 2, 3, dhe 4 kërkohet minimum 5 punëtor të cilët duhet të jenë të çertifikuar për siguri në punë.*

Në si kompani kemi dorëzuar listën e stafit punues me gjithsej 16 (përfshirë punonjësit me marrëveshje) punëtor dhe listën e punëtorëve nga ATK me gjithsej 11 punëtorë.
Gjithashtu kemi dorëzuar raportin e vlerësimit te riskut me listën e stafit punues dhe certifikatat respektive, gjithsej 10 punëtor.
Duke marr parasysh të gjitha këto te dhëna dokumentare te dërguara për stafin punues, vërtetësia e te cilave faktohet shumë lehtë pasi dokumentet figurojnë me datë para datës së njoftimit për kontratë, atëherë autoriteti kontraktues është dashur të kërkoj sqarime shtesë

konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, mirëpo që një gjë të tillë nuk e ka bërë, duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.
Sa për korrektësi ne po i bashkangjesim kontratat dhe CV për stafin punues te cilat pa dashje nuk janë ngritur ne platformën e-prokurimi.
Pra për shkak të lëshimit teknik nuk janë bashkangjitur kontratat dhe CV, mirëpo dëshmitë nga ATK-ja janë dëshmi konkrete se punëtorët janë të deklaruar në ATK, prandaj është dashur të kërkohen sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Gjithashtu autoriteti kontraktues në letrën standarde për tenderues të eliminuar ka dhënë si arsye të eliminimit si në vijim *"Nuk eshte kerkesa e DT lidhur me pasjijet dhe makinerite e kerkuara. Kjo sepse nuk kamioni me kran nuk eshte i registruar me libreze ndersa kamioni me kiber nuk ka regjistrim".*

Arsyeja e eliminimit tonë është e paqëndrueshme dhe njëkohësisht e pa bazuar për faktin se ne në ofertë kemi dorëzuar listën e pajisjeve së bashku me Aneksin 7.

Libreza e kamionit me kran me targa 01-146-LD me regjistrim: 14.06.2024 gjendet ne fletën e 6-7 te listës se pajisjeve, ndërsa përveç librezës kamioni me kran dhe automjetet shporta e disponojnë edhe informatën e kërkuar nga AK lidhur me lartësinë e operimit te pajisjeve.

Libreza e kamionit kiper me targa 01-611-MR e bashkangjitur ne listën e pajisjeve është me regjistrim shumë me te hershëm dhe pretendimi i AK është i drejte, mirëpo autoriteti kontraktues është dashur të kërkoj sqarime shtesë konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, sa i përket librezës.
Bashkangjitur e gjeni listën e pajisjeve me libreza te regjistrimit dhe dëshmi dokumentare rreth operimit te pajisjeve konform kërkesave të dosjes së tenderit, përmes të cilave vërtetohet se ne plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, pra jemi OE i përgjegjshëm.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë diskriminimi që po i bëhet kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë, ku po eliminohemi në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së dhe njëkohësisht po favorizohen OE të papërgjegjshëm duke u rekomanduar për kontratë.

Ne me dt.05.09.2024 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që nuk janë dhënë fakte konkrete në lidhje me një refuzim të tillë.

Në arsyetimin e tij autoriteti kontraktues e cek se kinse ne nuk e kontestojmë faktin që kemi ofertuar me çmim jo normalisht të ulët, mirëpo një gjë e tillë nuk qëndron pasi që ne e kemi sqaruar që autoriteti kontraktues është dashur të kërkoj sqarime shtesë konform dispozitave të nenit 61 të LPP-së në lidhje me çmimet me të cilat kemi ofertuar. Në vijim të arsyetimit autoriteti kontraktues mundohet të manipuloj me argumentet dhe pretendimet tona ankimore, ku e cek se kinse ne po e konfirmojmë që AK-ja na ka kërkuar sqarime shtesë, mirëpo në vazhdim të arsyetimit AK-ja bie në kundërshtim me vet arsyetimin e tij, pasi që e cek se neve na janë kërkuar sqarime shtesë në njoftimin mbi vendimin e dt. 14.06.2024, ku edhe ishim shpallur fitues të Lotit 4.

Pra me sqarimet të cilat na ishin kërkuar neve ishim rekomanduar për kontratë, pra AK-ja ishte bindur nga sqarimet tona. Andaj edhe në këtë rast është dashur të kërkohen sqarime shtesë dhe ne do ta kishim dëshmuar me fakte konkrete se çmimet me të cilat kemi ofertuar

nuk janë çmime jo normalisht të ulëta dhe se oferta jonë është në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore të LPP-së.
Në këtë rast nuk është respektuar aspekti procedural sipas nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.
Edhe nëse duket të jetë një tender me çmime jo normalisht të ulëta duhet të kërkohen sqarime dhe kjo përcaktohet në nenin 41.5 të RRPP Nr.001/2022.

41.5 Kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ultë në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tille nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktoj tenderin veçanërisht të ulët.
Sa i përket pretendimit tonë ankimor në lidhje me stafin dhe pajisjet e prezantuara nga ana jonë, AK-ja në arsyetimin e saj e vetëm ka përsëritur arsyen e njëjtë sikurse në njoftimin mbi vendimin e saj, duke mos pasur asnjë mundësi të dëshmoj të kundërtën e pretendimeve tona ankimore. Gjithashtu e njëjta nuk i ka marr parasysh fare dëshmitë e prezantuara nga ana jonë në lidhje me stafin dhe pajisjet dhe ky veprim i të njëjtës tregon qartë diskriminimin që po i bëhet kompanisë tonë si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë.

Autoriteti kontraktues përmend dispozita të tjera me qëllim të krijimit të opinionit se oferta jonë është me çmim jo normalisht të ulët e nuk përmend dispozitat konkrete që e rregullojnë këtë çështje.
AK-së nuk i ka marr parasysh sqarimet e as dëshmitë në lidhje me stafin dhe makineritë e ofruara nga ne dhe nuk ka marr parasysh përsëri nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, të cilat dispozita duhet ët zbatohen ën këtë rast dhe që janë përmbushur kushtet për zbatim të këtyre dispozitave.

Në lidhje me pretendimet tona ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë për Lot 2, 3 dhe 4 autoriteti kontraktues nuk i ka shqyrtuar fare të njëjtat pretendime dhe në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 108/A.

Edhe shqyrtimin e pretendimeve tona ankimore, AK-së i ka bërë në mënyrë të njëanshme dhe diskriminuese, sepse është marr vetëm me arsyet e eliminimit tonë, ndërsa në raport me pretendimet tona ankimore për OE e rekomanduar për kontratë i është shmangur përgjigjeve, prandaj edhe ky është një fakt se AK-së nuk ka mundur të argumentojë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore.

Pasi që AK-së nuk ka mundur të argumentoj të kundërtën e pretendimeve tona ankimore, e njëjta e ka cekur se kinse ne jemi palë pa interes në këtë aktivitet të prokurimit, mirëpo një gjë e tillë është e paqëndrueshme dhe e pa bazuar, madje tendencioze, sepse ne jemi palë me interes në këtë aktivitet të prokurimit. Faktin se ne jemi palë me interes në këtë aktivitet të prokurimit e vërtetojnë dëshmitë dhe argumentet e prezantuara me kërkesë për rishqyrtim e edhe tani me këtë ankesë, përmes të cilave vërtetohet se ne jemi OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti kontraktues pasi që nuk ka mundur të jep asnjë arsyetim konkret në lidhje me pretendimet tona ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, është munduar që në mënyrë të përgjithësuar të tregoj se OE të rekomanduar për kontratë janë të përgjegjshëm, mirëpo që nuk ka dhënë asnjë dëshmi konkrete për një gjë të tillë.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar, njëkohësisht është vendim diskriminues kundrejt kompanisë tonë dhe vendim favorizues për OE të rekomanduar për

kontratë. Andaj kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe paneli i OSHP-së të analizoj në detaje ankesën tonë dhe të nxjerrët një vendim meritor.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm.

Njëkohësisht AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "*Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.
Ndërsa pika (vi) e paragrafit 6 e nenit 7 të LPP-së e përcakton qartë që "*që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse*.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **Risamont SH.P.K.**
ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës **për Lot 2, 3 dhe 4** dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i** ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kostot e tilla do te llogariten ne fazat vijuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*